



Strasbourg, 23 nëntor 2001  
[ccje/docs2001/ccje(2001)op n°1e]

CCJE (2001) OP N°1

**KËSHILLI KONSULTATIV I GJYQTARËVE EUROPIAN (KKGjE)**

**OPINION Nr 1 (2001)**

**I KËSHILLIT KONSULTATIV TË GJYQTARËVE EUROPIAN (KKGjE)**

**PËR KOMITETIN E MINISTRAVE TË**

**KËSHILLIT TË EUROPËS**

**PËR STANDARDET**

**E PAVARËSISË SË GJYQËSORIT**

**DHE PALËVIZSHMËRINË E GJYQTARËVE**

**(REKOMANDIMI Nr. R (94) 12 PËR PAVARËSINË, EFIKASITETIN DHE ROLIN E GJYQTARËVE SI DHE RELEVANCËN E STANDARDEVE TË VETA DHE ÇFARËDO STANDARDE TJERA NDËRKOMBËTARE PËR PROBLEMET AKTUALE TË KËSAJ FUSHE)**

1. Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve të Europës (KKGjE) ka përpiluar këtë opinion në bazë të reagimeve të Shteteve në këtë pyetësor, teksteve të përgatitura nga Pala Punuese e KKGjE dhe teksteve të përgatitura nga Kryesuesi dhe Nën Kryesuesi i KKGjE si dhe specialisti i KKGjE për këtë temë, z. Giacomo OBERTO (Itali).

2. Materiali i disponueshëm për KKGjE përfshin një numër deklaratash, pak a shumë zyrtare, mbi parimet e pavarësisë së gjyqësori.

3. Si shembuj të rëndësishëm zyrtar mund t'i referohemi:

- Parimeve bazë të KB për pavarësinë e gjyqësorit (1985),
- Rekomandimit Nr. R (94) 12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për Shtetet Anëtare për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve.

4. Zhvillimet më pak formale kanë qenë:

- Karta Europiane e Statutit të Gjyqtarëve e adaptuar nga pjesëmarrësit prej shteteve Europiane dhe dy shoqatave ndërkombëtare të gjyqtarëve në takimin e mbajtur në Strasburg prej 8 deri 10 korrik 1998, mbështetur poashtu edhe nga takimi i Kryetarëve të Gjykatave Supreme të shteteve të Europës Qendrore dhe Lindore në Kyiv me 12-14 tetor 1998, dhe prapë përmes gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të Ministrive të Drejtësisë prej 25 shteteve Europiane në Lisbonë me 8-10 prill 1999,
- Deklaratat e delegatëve të Këshilleve të larta të gjyqtarëve apo shoqatave të gjyqtarëve sikurse ato që kanë rezultuar prej takimit në Varshavë dhe Slok me 23-26 qershor 1997.

5. Materiali tjerër i përmendur gjatë diskutimeve të KKGjE ka qenë:

- Deklarata e Pekinit për parimet e pavarësisë së gjyqësorit në rajonin Laëasia (gusht 1997), të nënshkruar tani nga 32 shefa të drejtësisë së atij rajonin,
- Udhëzimet e Shtëpisë Latimer për Commonwealth (19 qershor 1998), rezultatin e kollokviumit të vijuar nga përfaqësuesit e 23 shteteve të Commonwealth-it ose territoreve tej-oqeanike dhe të sponsoruara nga gjyqtarët e Commonwealth-it dhe gjyqtarët me mbështetjen e Sekretariatit të Commonëalth-it dhe zyres së Commonwealth -it.

**6. Gjatë diskutimeve të KKGjE, anëtarët e KKGjE kanë theksuar se gjëja më kritike nuk është përfeksioni i parimeve e më pak harmonizimi i institucioneve në krahasim me vënien në efekt të plotë të parimeve tanimë të zhvilluara**

7. KKGjE gjithashtu ka shqyrtuar faktin nëse është e përshtatshme të bëhen përmirësimet e zhvillimeve të mëtejme të parimeve ekzistuese të përgjithshme.

8. Qëllimi i këtij opinion është të shikojmë në detaje më të hollësishme një numër temash të diskutuara dhe të identifikojmë problemet apo çështjet e lidhura me pavarësinë e gjyqtarëve që do të përfitonin prej vëmendjes.

9. Propozimi për titujt e temave ka qenë si vijon:

- Arsyetimi i pavarësisë së gjyqësorit
- Niveli në cilin garantohet pavarësia e gjyqësorit
- Baza e emërimit ose promovimit

- Trupat emëruese dhe konsultative
- Koha e mbajtjes –periudha e emërimit
- Koha e mbajtjes- palëvizshmëria dhe disiplina
- Pagesa
- Liria prej influencës së jashtme të papërshtatshme
- Pavarësia brenda gjyqësorit
- Roli i gjyqësorit

Në rrjedhën e rishikimit të këtyre temave, KKGJE ka kërkuar të identifikojë shembujt specifik të vështirësive apo rreziqeve ndaj pavarësisë. Më tej, ka identifikuar rëndësinë e parimeve të diskutuara ( në veçanti ) për aranzhimet dhe praktikën e emërimit dhe ri-emërimit të gjyqtarëve në gjykata ndërkombëtare. Kjo temë është shtjelluar në paragrafet 52, 54-55).

#### *Arsyetimi i pavarësisë së gjyqësorit*

10. Pavarësia e gjyqësorit është parakusht për sundimin e ligjit dhe garancion thelbësor për një gjykim të drejtë. Gjyqtarët kanë “ përgjegjësinë të marrin vendime për jetën, lirinë, të drejtat, detyrat dhe pronën e qytetarëve” (recitim i parimeve bazë të KB, të reflektuara në deklaratën e Pekinit dhe nenet 5 dhe 6 të Konventës Europiane për të drejtat e njeriut ). Pavarësia e tyre nuk është prerogativë ose privilegj në interesin e tyre mirëpo në intereset e sundimit të ligjit dhe të atyre që kërkojnë dhe presin drejtësi.

11. Kjo pavarësi duhet të ekzistojë në lidhjet me shoqërinë në përgjithësi dhe në veçanti me palët në çfarëso kontesti në të cilin gjyqtarët duhet të gjykojnë. Gjyqësori është një prej tri shtyllave bazë dhe të barabarta në shtetin demokratik modern<sup>1</sup>. Ka një rol të rëndësishëm dhe funksione në lidhje me dy shtyllat tjera. Siguron se qeveria dhe administrate mund të mbahet përgjegjëse për veprimet e veta dhe për sa i përket legjislaturës është e involvuar në sigurimin se ata mund të përputhen me cilindo institucion relevant apo ligj më të lartë ( sikurse ai i Bashkësisë Europiane).Për të përmbushur rolin e vet në këtë aspekt, gjyqësori duhet të jetë i pavarur prej këtyre trupave, ku përfshihet liria prej lidhjeve të papërshtatshme dhe prej influencës së këtyre trupave<sup>2</sup> . Pavarësia pra shërben si garancion për paanësi<sup>3</sup>. Kjo ka implikime, domosdoshmërisht, për pothuajse çdo aspekt të karrierës së gjyqtarit: prej trajnimit deri te emërimi dhe promovimi e disiplinimi.

1 KKGJE nuk do të përpiqet të precizojë literaturën ekstensive për temën e ndarjes së autoritetit dhe teksti jep vetëm një përgjegjësi të thjeshtuar, pasi që është demonstruar me vend në Gjyqësori dhe Ndarja e Autoritetit të Lopez Guerrës ( dokumenti i Komisionit të Venedikut për Konferencën për Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Supreme prej rajonit të Afrikës Jugore, shkurt 2000) .

2 Për një analizë më të sofistikuar që identifikon pamundësitë dhe mund të thuhet edhe padëshirueshmëritë e cilitdo tërësisht të pavarur prej të gjitha ndikimeve për shembull parametrat social dhe kulturor , shih Rolin e Pavarësisë së Gjyqësorit për Sundimin e Ligjit , Prof. Henrich (dokumenti i Komisionit të Venedikut për punëtorinë në Kirgistan, prill 1998)

3 Shih paragrafin 12 më poshtë

12. Pavarësia e gjyqësorit parasupozon paanësia e plotë për sa i përket gjyqtarëve. Kur bëhet gjykimi i çfarëdo pale gjyqtarët duhet të jenë të paanshëm, pa ndonjë lidhje, prirje apo paragjykim që ka ndikim- ose mund të shihet si ndikuese në aftësinë e tyre për të gjykuar në mënyrë të pavarur. Në këtë aspekt, pavarësia e gjyqësorit është një elaborim i parimit fundamental që thotë ” asnjë njeri nuk mund të gjykojë në rastin e vet”. Ky parim gjithashtu ka rëndësi shumë më të madhe përtej ndikimit në palët e përfshira në cilindo kontest. Jo vetëm palët e përfshira në ndonjë kontest mirëpo edhe shoqëria si tërësi duhet të jetë në gjendje t’i bësojë gjyqësorit. Pra Gjyqtari nuk duhet thjeshtë të jetë i lirë për sa i përket ndonjë lidhjeje të papërshtatshme, prirjeje apo ndikimi, ai ose ajo duhet gjithashtu ti lënë përshtypje vrojtuesit të pranueshëm se janë të lirë prej këtyre lidhjeve. Përndryshe, besimi në pavarësinë e gjyqësorit mund të nënvlerësohet.

13. Arsyetimi i pavarësisë së gjyqësorit, siç deklarohet më lartë, siguron çelësin përmes së cilit do të vlerësohet implikimet praktike- që do të thotë, karakteristikat që janë të domosdoshme për ta siguruar atë, në nivel kushtetues apo nivelin më të ultë ligjor<sup>4</sup>, si dhe në praktikat e përditshme, në shtetet individuale. Fokusi i këtij opinion është në kornizën e përgjithshme institucionale dhe garanton sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit e jo vetëm paanshmërinë personale që bazohet vetëm në parimin ( në fakte dhe dukje) e gjyqtarit në çfarëdo rasti të veçantë. Edhe pse ka një shkelje, propozohet që tema e fundit të adresohet në kontekstin e ekzaminimit të KKGjE të sjelljes së gjyqësorit dhe standardeve të sjelljes.

*Niveli në të cilin garantohet pavarësia e gjyqësorit*

14. Pavarësia e gjyqësorit duhet të garantohet përmes standardeve vendore në nivelin më të lartë të mundshëm. Sipas kësaj, Shtetet duhet të përfshijnë konceptin e pavarësisë së gjyqësorit ose në kushtetutat e tyre ose në parimet fundamentale të pranuar nga shtetet të cilat nuk kanë kushtetutë të shkruar mirëpo në të cilat respekti për pavarësi të gjyqësorit është garantuar me kulturën e vjetër dhe traditën. Kjo shënon rëndësinë thelbësore të pavarësisë përdërisa njihet edhe pozita e veçantë e juridiksioneve me të drejtë zakonore ( veçanërisht Anglia dhe Skotlanda) me një traditë të gjatë të pavarësisë mirëpo pa kushtetuta të shkruara.

15. Parimet bazë të KB sigurojnë për pavarësinë e gjyqësorit “ të garantohet nga Shteti dhe të ruhet në Kushtetutë ose ligjin e shtetit”. Rekomandimi nr. R (94) 12 specifikon (në fjalinë e parë të parimit 1.2 ) se “ pavarësia e gjyqtarëve do të garantohet sipas dispozitave të Konventës [ Europiane] [ për të drejtat e njeriut] dhe parimet kushtetuese për shembull duke futur dispozita specifike në kushtetutë apo në legjislacion tjetër apo duke inkorporuar dispozitat e këtij rekomandimi në ligjin e brendshëm”.

16. Karta Europiane për statutin e gjyqtarëve siguron në mënyrë edhe më specifike: ” në secilin shtet European parimet thelbësore të statutit të gjyqtarëve janë vendosur në normat e brendshme të nivelit më të lartë të mundshë dhe rregullat në normat e nivelit legjislativ së paku”. **Ky përshkrim më specifik i Kartës Europiane është pajtuar me mbështetjen e përgjithshme të KKGjE. KKGjE rekomandon**

---

<sup>4</sup> Shih paragrafet 14-16 më poshtë

**adaptimin e tij në vend të dispozitave që janë më pak specifike në fjalinë e parë të parimit 1.2 të Rekomandimit Nr. R (94) 12**

*Baza e emërimit ose promovimit*

17. Parimet bazë të KB deklarojnë ( paragrafi 13) : “ Promovimi i gjyqtarëve, kudo që ekziston një sistem i tillë, duhet të bazohet në faktorët objektivë, në veçanti në aftësi, integritet dhe përvojë”. Rekomandimi nr. R (94) 12 gjithashtu është i qartë: “Të gjitha vendimet në lidhje me karrierën profesionale të gjyqtarëve duhet të bazohen në kriteret objektive dhe selektimi e kariera e gjyqtarëve duhet të bazohet në meritë, duke pasur parasysh kualifikimet, integritetin, aftësitë dhe efikasitetin”. Rekomandimi nr. R (94) 12 e bën të qartë aplikueshmërinë në të gjithë personat që ushtrojnë funksionet gjyqësore, duke përfshirë ata që merren me çështje ligjore kushtetuese, civile, komerciale dhe administrative ( si dhe në shumë raste për ti dhënë gjyqtarëve dhe personave tjerë ushtrimin e funksioneve gjyqësore). Pra ekziston një pranim i përgjithshëm se të dyja emërimet duhet të bëhen në bazë të “ meritës” duke u bazuar në “ kriteret objektive” dhe se konsiderimet politike *duhet* të jenë të papranueshme.

18. Problemet qendrore mbeten (a) përmbajtja e aspiratave të përgjithshme drejt emërimeve “ të bazuara në meritë” dhe “ objektiviteti” dhe (b) përputhja e teorisë dhe realitetit. Tema aktuale gjithashtu lidhet me dy temat e ardhshme ( *trupi emërues dhe koha e mbajtjes*).

19. Në disa shtete, sipas kushtetutës ka inpute politike në emërimin e gjyqtarëve. Kur zgjedhen gjyqtarët ( nga njerëzit sikurse në nivelin kantonal Zvicrran apo nga Parlamenti sikurse në nivelin federal Zvicrran, në Slloveni dhe “ ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në rastin e Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane dhe një pjesë të Gjykatës Kushtetuese Italiane), qëllimi, pa dyshim, është t’i japë gjyqësorit një përforsim demokratik të drejtëpërdrejtë në ushtrimin e funksionit të vet. Emërimi apo promovimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet për të zvogëluar konsideratën politike të palës. Nëse ka ndonjë rrezik ekzistues apo që do të mund të përdorej në një mënyrë të tillë, metoda mund të shihet si rrezik e jo përparësi.

20. Edhe në rastet kur ekziston autoriteti i veçantë me përgjegjësi për, ose në proces të emërimit ose promovimit, në praktikë konsideratat politike nuk përjashtohen domosdoshmërisht. Kështu në Kroaci, këshilli i lartë gjyqësor, i përbërë prej 11 anëtarëve (shtatë gjyqtarë, dy avokatë dhe dy profesorë) ka përgjegjësinë për emërimet të tilla. Mirëpo Ministri i Drejtësisë mund të propozojë 11 anëtarët që të zgjedhen nga dhoma e përfaqësuesve së Parlamentit Kroat dhe Këshilli i lartë gjyqësor duhet të konsultohet me komitetin gjyqësor të Parlamentit kroat, të kontrolluar prej palës që formon Qeverinë për momentin, për sa i përket këtyre emërimeve. Edhe pse neni 4 i Kushtetutës së amendamentuar kroate i referohet parimit të ndarjes së autoritetit, ajo gjithashtu deklaron se këtu përfshihen “ të gjitha format e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe reciprok të mbajtësve të autoritetit” që me siguri se nuk e përjashtojnë ndikimin politik në emërimet gjyqësore ose promovim. Në Irlandë, edhe pse ka komision për emërimet gjyqësore<sup>5</sup> konsideratat politike

---

<sup>5</sup> Shih paragrafin 43 më poshtë.

prapë mund të përcaktojnë cilët prej kandidatëve rival, të aprovuar nga komisioni janë ose po emërohen nga Ministri i Drejtësisë (dhe komisioni nuk ka ndonjë rol në lidhje me promovimet).

21. Në shtetet tjera, sistemet aktuale ndryshojnë prej shteti në shtet për sa i përket karrierës gjyqësore ( shumica e shteteve me ligj civil) dhe ato ku gjykatësit emërohen prej rangut të praktikuesve me përvojë ( shtetet me ligj zakonor, sikurse Qipro, Malta dhe Britania e Madhe si dhe shtetet tjera sikurse Danimarka).

22. Në shtetet me karrierë gjyqësore, emërimi fillestar i gjyqtarëve zakonisht varet prej suksesit objektiv në ekzaminim. Çështjet e rëndësishme duket se janë (a) a është i mjaftueshëm ekzaminimi kompetitiv – a nuk duhet të vlerësohen kualitetet personale dhe të mësohen e ekzaminohen aftësitë praktike? (b)A duhet të involvohet në këtë fazë një autoritet i pavarur prej ekzekutivit dhe legjislaturës- në Austri për shembull Personalsenates (i përbërë prej pesë gjyqtarëve)kanë rol formal në rekomandimin e promovimeve mirëpo asnjë në lidhje me emërimet.

23. Në të kundërtën, kur gjyqtarët janë apo mund të caktohen prej rangut të praktikuesve me përvojë, ekzaminimet nuk ka gjasa të jenë relevante dhe aftësitë praktike dhe konsultimet me persona tjerë që kanë përvojë direkte të kandidatit kanë gjasa të jenë baza e emërimit.

24. Në të gjitha situatat e lartpërmendura, sugjerohet që standardet objektive të kërkohen jo thjeshtë për të përjashtuar influencën politike mirëpo për arsye tjera sikurse rreziku i favorizimit, konzervatizimit dhe klonimit që mund të paraqiten nëse emërimet janë bërë në një mënyrë të pastrukturuar ose në baza të rekomandimeve personale.

25. Cdo “ kriter objektiv” që kërkon të sigurojmë se selektimi apo kariera e gjyqtarëve “ bazohet në meritë, duke pasur parasysh kualifikimet, integritetin, aftësitë dhe efikasitetin” është i lidhur me kushtet e përgjithshme. Për më tepër, thelbësore është përmbajtja e tyre aktuale dhe efekti në cdo shtet në veçanti. **KKGjE rekomandon që autoritetet përgjegjëse në shtetet anëtare për emërimet dhe promovimet duhet tani të paraqesin, publikojnë dhe të vejnë në efekt kriteret objektive me qëllim që të sigurohet se selektimi dhe promovimi i gjyqtarëve bëhet “ në bazë të meritës, duke marrë parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin”.** Pasi të bëhet kjo, ata trupa ose autoritete përgjegjëse për çfarëdo emërimi apo promovimi do të obligohen të veprojnë në pajtueshmëri dhe së paku do ta kenë të mundur të bëjnë kontrollin e përmbajtjes së kriterëve të adaptuara dhe efektin e tyre praktik.

26. Reagimet në pyetësor tregojnë një mungesë të madhe të ndonjë apo llojit të tillë të kriterëve. Kriteret e përgjithshme janë publikuar nga Lordi Kancelar në Britaninë e Madhe dhe ekzekutivi Skocez ka lëshuar një dokument konsultimi. Ligji Austriak përcakton kriteret për promovim. Shumë shtete thjeshtë mbështeten në integritetin e këshilleve të pavarura të gjyqtarëve përgjegjës për emërimet apo rekomandim të emërimeve për shembull Qipro, Estonia. Në Finlandë, bordi këshillëdhënës relevant krahason meritat e kandidatëve dhe propozimet e tij për ndonjë emërim *përfshijnë arsyet për vendimin e tyre*. Ngjashëm, në Islandë, Komiteti për selektim<sup>6</sup> i siguron

---

<sup>6</sup> përbëhet prej tre avokatëve të emëruar nga Ministri i Drejtësisë me rekomandimin e Gjykatës Supreme, Shoqatës e Gjyqtarëve dhe Shoqatës së Avokatëve, në aplikacionet dhe kualifikimet e të cilëve komentohen prej Gjykatës Supreme.

Ministrit të Drejtësisë vlerësimin e shkruar të aplikantëve për qarqe gjyqësore përderisa Gjykata Supreme këshillon për kompetencat e emërimit në Gjykatë Supreme. Në Gjermani, në nivelin federal dhe lokal, këshillet për emërim gjyqësor mund të jenë përgjegjëse për dorëzim të opinionit me shkrim ( pa arsye të detajuar) për sa i përket përshtatshmërisë së kandidatëve për emërim gjyqësor dhe promovim, gjë që nuk e obligon Ministrin e Drejtësisë, mirëpo mund të dërgojë deri tek kritikizmi ( ndonjëherë publik) nëse ai nuk i përcjell ato. Dhënia e arsyes mund të shihet si disiplinë e shëndoshë dhe do të shërbente për të plotësuar kriteret që aplikohen në praktikë mirëpo konsideratat kundërbalancuese gjithashtu mund të bëhen për të luftuar kundër dhënies së arsyeve në raste individuale ( për shembull ndjeshmëria egjykimit ndërmjet kandidatëve të krahasuar ngushtë dhe privatësisë për sa i përket burimeve të informatës).

27. Në Lituanë, edhe pse nuk ka ndonjë kriter të qartë, promovimi qeverisës ekziston, performanca e gjyqtarëve të qarkut monitorohet përmes serisë së kriterëve kuantitative dhe kualitative bazuar kryesisht në statistika ( duke përfshirë statistikat në lidhje me kthimet në apel) dhe bëhet subjekt i raporteve për Departamentin e Gjykatave në Ministrinë e Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë ka vetëm një rol indirekt në selektim dhe promovim. Mirëpo sistemi i monitorimit është “ kritikuar strikt” nga Shoqata e Gjyqtarëve Lituanëz. Të dhënat statistikore kanë një rol të rëndësishëm social në të kuptuarit dhe përmirësimet e punës dhe efikasitetit të gjykatave. Mirëpo ato nuk janë të njëjtat sikurse standardet objektive për vlerësim, për sa i përket emërimit në post të ri ose promovimit apo ndryshe. Kujdes i shtuar kërkohet gjatë përdorimit të statistikave si mjet ndihmës në këtë kontekst.

28. Në Luksemburg, promovimi thuhet se bazohet në parimin e senioritetit. Në Holandë ka ende elemente të sistemit të hershëm të senioritetit dhe në Belgjikë dhe Itali kriteret e përcaktuara në mënyrë objektive në baza të senioritetit dhe kometencave e përcaktojnë promovimin. Në Austri, për sa i përket rekomandimeve për promovim të bëra nga Personalsenates (të përbërë prej pesë gjykatësve) për Ministrin e Drejtësisë, pozicioni sipas ligjit është që senioriteti të merret parasysh vetëm në raste të aftësisë së njejtë profesionale të kandidatëve.

29. Karta Europiane për statutin e gjyqtarëve adreson sistemet për promovim “ kur nuk bazohet në senioritet” (paragrafi 4.1.) dhe Memorandumi Shpjegues thkson se ky “ është sistem të cilin Karta nuk e ka përjashtuar në asnjë mënyrë nesepe është dizajnuar të ofrojë mbrojtje shumë efektive për pavarësi”. **Edhe pse përvoja adekuate është parakusht relevant për promovim, KKGjE ka konsideruar se senioriteti në botën moderne nuk është më përgjithësisht<sup>7</sup> i pranueshëm si parim qeverisës për përcaktim të promovimit.** Publiku ka një interes të madh jo vetëm në pavarësi por gjithashtu edhe në cilësi të gjyqësorit të vet e në veçanti në kohët e ndryshimeve , në cilësinë e liderëve të gjyqësorit. Ka një sakrificë potenciale në dinamizëm në sistemin e promovimit të bazuar plotësisht në senioritet gjë që mund të mos arsyetohet me ndonjë fitim real në pavarësi. Megjithatë KKGjE ka konsideruar se kërkesat e senioritetit bazuar në vitet e përvojës profesionale mund të asistojnë mbështetjen e pavarësisë.

<sup>7</sup> KKGjE megjithatë është i vetëdijshëm në disa raste kur një sistem i tillë duket se është i suksesshëm p.sh. për emërimin e shefit gjyqësor në Indi dhe Japoni .

30. Në Itali dhe deri diku në Suedi, statusi, funksioni dhe pagesa e gjyqtarëve nuk janë kombinuar. Pagesa bëhet pothuajse automatikisht në bazë të përvojës dhe përgjithësisht dallon sipas statusit apo funksionit. Statusi varet prej promovimit mirëpo nuk përfshinë domosdoshmërisht prezencën në ndonjë tjetër gjykatë. Kështu që gjyqtari me status apelimi mund të preferojë të vazhdojë funksionin në instancën e parë. Në këtë mënyrë sistemi synon të rrisë pavarësinë duke larguar çfarëdo stimulimi financiar për kërkim të promovimit ose funksionit të ndryshëm.

31. KKGjE ka marrë parasysh pyetjen e barazisë ndërmjet femrave dhe meshkujve. Udhëzimet e dhomës Latimer deklarojnë: “ Emërimet e të gjitha niveleve të gjyqësorit duhet të kenë si objektivë arritjen e barazisë ndërmjet femrave dhe meshkujve”. Në Angli “ parimet udhëzuese sigurojnë emërimin e bazuar në mënyrë strikte në meritë “ pa marrë parasysh gjininë, origjinën etnike, statusin martesor, orientimin seksual ...”, mirëpo Lordi Kancelar e ka bërë të qartë dëshirën e tij që të inkurajojë aplikimet për emërim gjyqësor prej anës së femrave dhe minoriteteve etnike. Këto qartazi janë qëllime të përshtatshme. Delegati Austriak ka raportuar se në Austri , kur ka pasur dy kandidatë me kualifikime të njejta, gjithmonë është siguruar që të emërohet kandidati i gjinisë së nën-përfaqësuar. Edhe kur ka supozime se ky reagim pozitiv i limituar në problemin e nën-përfaqësimit nuk do të paraqiste ndonjë problem ligjor, KKGjE ka identifikuar si vështirësi praktik , së pari e thekson një fushë të nën-përfaqësimit potencial ( gjinia ) dhe së dyti se do të mund të kishte argumente rreth asaj se cka e bën nën-përfaqësimin, në rrethana të ndonjë shteti specifik, në një fushë të tillë. **KKGjE nuk propozon dispozitën sikurse në Austri si standard ndërkombëtar të përgjithshëm mirëpo e thekson nevojën për arritje të barazisë përmes “ parimeve udhëzuese” sikurse atyre të referuara në fjalinë e tretë më lartë.**

#### *Trpat emëruese dhe konsultative*

32. KKGjE ka theksuar një diversitet të madh të metodave përmes të cilave emërohen gjyqtarët. Ka një unanimitet evident se emërimet duhet të “ bazohen në meritë”.

33. Metodatat e ndryshme aktualisht të përdorura për të selektuar gjyqtarët mund të shihen si ato që kanë përparësi dhe dobësi: mund të thuhet se zgjedhja e jep një legjitimitet më të drejtpërdrejtë demokratik, por ajo përfshin një kandidat në një fushatë, në politikë dhe në tundimin për të blerë ose të japë favore. Bashkë-opzioni nga gjyqësori ekzistues mund të prodhojë kandidatë të kualifikuar teknikisht, por rrezikon konservatorizmin dhe favorizimit të miqve (apo "klonimin")<sup>8</sup> - dhe do të konsiderohet si jo- demokratike pozitivisht në disa procese të menduarit kushtetues. Emërimi nga ekzekutivi apo legjislativi mund të argumentohet për të përforcuar legjitimitetin, por mbart një rrezik të varësisë nga ato pushtetet e tjera. Një tjetër metodë përfshin emërimin nga një organ i pavarur.

34. Ka hapësirë për brengosje se diversiteti aktual i qasjes mund të ndihmojë vazhdimin e ndikimit politik të paligjshme gjatë emërimeve. KKGjE ka theksuar pikëmpamjen e specialistit, z. Oberto se procedurat jo-formale të emërimit dhe ndikimi gjyqësor politik i tepërt në shtetet përkatëse nuk ishin modele të dobishme në demokraci tjera të reja ku ishte vitale të sigurohet pavarësia e gjyqësorit përmes paraqitjes së organeve jo-politike emëruese.

---

<sup>8</sup> shih paragrafin 24 më lartë.



35. KKGJE ka theksuar, duke marrë për model të demokracisë së re, se në Republikën Çeke emërimet gjyqësore po bëhen prej anës së Kryetarit të Republikës për mocion të Ministrisë së Drejtësisë dhe promocionet (p.sh. transferi në një gjykatë më të lartë ose pozicion të kryesuesit ose zëvendësit të kryesuesit ) prej anës së presidentit ose Ministrit. Asnjë Këshill Gjyqësor Suprem nuk ekziston edhe pse gjyqtarët janë pjesë e komiteteve që selektojnë kandidatë për emërim gjyqësor.

36. Rekomandimi nr R (94) 12 aktualisht mbron pozicionin e vet në këtë fushë. Fillon duke supozuar një organ të pavarur emërues:

Autoriteti që merr vendimin për selektim dhe promovim të gjyqtarëve duhet të jetë i pavarur për qeveri dhe administratë. Me qëllim të ruajtjes së pavarësisë , rregullat duhet të sigurojnë se anëtarët janë selektuar nga gjyqësori dhe se autoriteti vendosë vet për rregullat e veta procedurale”

Por pastaj vazhdon të krijojë dhe të sigurojë një sistem shumë të ndryshëm:

“Megjithatë, kur dispozitat kushtetuese ose ligjore dhe tradita i mundëson gjyqtarëve të emërohen nga qeveria atëherë duhet të ketë garancion për të siguruar se procedurat e emërimit të gjyqtarëve janë transparente dhe të pavarura në praktikë dhe se vendimet nuk do të influencohen prej ndonjë arsye tjetër përveç atyre të lidhura me kriteret objektive të përmendura më lartë”.

Shembujt që përcjellin “ garancionin” ofrojnë fushëveprim edhe më të madh për relaksim të procedurave formale- ato fillojnë me një organ të pavarur special për të dhënë këshilla të cilat qeveria “ i përcjell në praktikë” , përfshijnë “ të drejtën për apel kundër një vendimi tek një autoritet i pavarur” dhe përfundonjë me një mundësi të dobët ( të shprehur në mënyrë jo-precize) se është e mjaftueshme nëse “ autoriteti që merr vendimin kujdeset për influencat e tepërta dhe të papërshtatshme”.

37. Baza në këtë formulim është gjetur në kushte me 1994. Mirëpo KKGJE është brengosur për natyrën e paqartë dhe të hapur në kontekst të Europës më të gjerë, ku “ traditat” ligjore ose kushtetuese janë më pak relevante dhe procedurat formale janë domosdoshmëri ku me të cilat është rrezik të bëhen përjashtime. **Për këtë shkak, KKGJE ka konsideruar se çdo vendim në lidhje me emërimin ose promovimin e gjyqtarit duhet të bazohet në kriteret objektive dhe mund të merret ose prej autoritetit të pavarur ose të jetë garancion për të siguruar se nuk është bazur në asgjë tjetër pos atyre kriterëve.**

38. KKGJE ka pranuar se mund të mos jetë e mundur të shkoj më tej për sa i përket diversitetit të sistemeve që aktualisht janë pranuar në Shtetet Europiane. KKGJE si një organ këshillëdhënës me mandat për shqyrtim të ndryshimeve të mundshme në standardet ekzistuese dhe praktika si dhe zhvillimin e standardeve të pranueshme përgjithësisht. Më tej, Karta Europiane për statutin e gjyqtarëve shkon edhe më tej se sa Rekomandimi nr. R (94) 12, duke siguruar si vijon:

“Për sa i përket cdo vendimi që ka ndikim në selektimin, rekrutimin, progresin në karrierë ose përfundimin e karrierës së gjyqtarit statute parashikon intervenimin e një autoriteti të pavarur me fuqi ekzekutive dhe legjislative brenda të cilit së paku gjysma e atyre që janë present janë gjyqtarë të zgjedhur prej bashkepunëtorëve të tyre duke përcjellë metoda që garantojnë përfaqësimin më të gjerë të gjyqësorit.”

39. Memorandumi Shpjegues shpjegon se “ intervenimi” i një autoriteti të pavarur është synuar në një kuptim më të gjerë për të mbuluar një opinion, rekomandim ose propozim si dhe një vendim aktual. Karta Europiane ende shkon përtej praktikës aktuale në shumë shtete Europiane. (nuk është befasuese se në takimin e delegatëve të Keshilleve të Larta të Gjyqtarëve dhe Shoqatës së Gjyqtarëve të mbajtur në Varshave me 23-26 qershor 1997 është shprehur dëshira për kontroll më të plotë të gjyqësorit për sa i përket emërimeve dhe promovimit gjyqësor që lobohet prej Kartës Europiane).

40. Reagimet në pyetësor tregojnë se shumica e shteteve Europiane kanë paraqitur një organ të pavarur prej ekzekutivit dhe legjislativit me një rol përjashtues apo më të vogël për sa i përket emërimeve dhe promovimeve ( kur është relevante); shembujt janë Andora, Belgjika, Qipro, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Islanda, Irlanda, Italia, Lituania, Moldavia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Rumania, Rusia, Sllovakia, Sllovenia, “ Ish republika Jugosllave e Maqedonisë” dhe Turqia.

41. Mungesa e një trupi të tillë është ndjerë si një dobësi në Republikën Çele. Në Maltë ekziston një trup i tillë mirëpo fakti se konsultimi i tij prej autoritetit emërues<sup>9</sup> ka qenë opsional është ndjerë si dobësi. Në Kroaci, shkalla e influencës politike potenciale mbi organin është identifikuar si problem<sup>10</sup>.

42. Sistemet në vijim do të shërbejnë si tre shembuj të këshillit të lartë gjyqësor në përputhje me sugjerimet e Kartës Europiane.

i) Sipas nenit 104 të Kushtetutës Italiane, një këshill i tillë përbëhet prej Presidentit të Republikës, Kryetarit të parë dhe Administratorit të Përgjithshëm të Gjykatës së Kasacionit, 20 gjyqtarë të zgjedhur prej gjyqësorit dhe 10 anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti në sesion të përbashkët të profesorëve universitar dhe avokatëve me përvojë 15 vjeçare. Sipas nenit 105, përgjegjësia e tyre është “ të emërtojë, rekrutojë dhe transferojë, të promovojë dhe të ndër marrë masa disiplinore për sa i përket gjyqtarëve në pajtim me rregullat e organizatës gjyqësore”.

ii) Ligjet Hungareze për reforma në Gjykata të 1997 themelojnë Këshillin Gjyqësor Nacional që ushtron autoritetin e administrimit të gjykatës duke përfshirë emërimin e gjykatësve. Këshilli përbëhet prej Kryetarit të Gjykatës Supreme ( Presidentit të këshillit ), nëntë gjyqtarëve, Ministrit të Drejtësisë, Kryeprokurorit, Presidentit të shoqatës së avokatëve dhe dy deputetëve të Parlamentit.

iii) Në Turqi, Këshilli Suprem selekton dhe promovon edhe gjyqtarët edhe prokurorët publik. Përbëhet prej shtatë anëtarëve duke përfshirë pesë gjyqtarë prej Gjykatës së Kasacionit dhe Këshillit të Shtetit. Ministri i Drejtësisë e kryeson atë e kryeson atë dhe Nën-Sekretari i Ministrit të Drejtësisë është poashtu ish-anëtar i Këshillit.

<sup>9</sup> Presidenti në konsultim me Kryeministrin.

<sup>10</sup> Shih paragrafin 20 më lartë.

44. Një shembull i zakonshëm ligjor është siguruar nga Irlanda, ku Bordi Gjyqësor për Emërime është themeluar nga Akti për Gjykatat dhe zyrtarët gjyqësor 1995, paragrafi 13 me qëllim të “identifikimit të personave dhe informimit të Qeverisë për përshtatshmërinë e atyre personave për emërim në gjykatë”. Anëtarësimi i nëntë personave përbëhet prej kryegjyqtarit, tre krytarëve të gjykatës së lartë, gjykatës së rrethit dhe qarkut, administruesit të përgjithshëm, një avokati praktikant të emëruar prej Kryesuesit të Shoqatës Ligjore dhe deri në tre persona tjerë të emëruar prej Ministrit të Drejtësisë, të angazhuar në apo me njohuri apo përvojë në tregti, financa ose administratë ose më përvojë si shfrytëzues të shërbimeve gjyqësore. Mirëpo nuk e përjashton gjithë influencën politike prej procesit<sup>11</sup>.

45. Modeli Gjerman ( më lartë) përfshin këshillet roli i të cilave mund të ndryshojë varësisht prej asaj nëse kemi të bëjmë me gjykatë federale apo lokale dhe prej nivelit të gjykatës. Ka këshille për emërime gjyqësore roli i të cilave është tërësisht këshillëdhënës. Përveç kësaj, disa German Länder sigurojnë se gjyqtarët do të zgjedhen nga Ministri kompetent dhe komiteti për selektim të gjyqtarëve. Ky komitet zakonisht ka të drejtën e vetos. Zakonisht përbëhet prej anëtarëve të Parlamentit, gjyqtarëve të zgjedhur prej kolegëve të tyre dhe gjykatësit. Involvimi i Ministrit të Drejtësisë në Gjermani perceptohet si një element i rëndësishëm demokratik sepse ai është përgjegjës ndaj Parlamentit. Poashtu perceptohet si i rëndësishëm në aspektin kushtetues ashtu që organi aktual emërues nuk duhet të përbëhet vetëm prej gjyqtarëve ose prej shumicës së gjyqtarëve.

46. Edhe në sistemet ligjore ku standardet e mira kanë qenë të vrojtuar me forcë prej traditës dhe vetë-disiplinës jo formale, në të shumtën e herave nën kontrollin e mediave të lira, ka pasur njohje në rritje e sipër gjatë viteve të fundit të nevojës për më tepër masa mbrojtëse objektive dhe formale. Në shtetet tjera, sidomos në ato të shteteve të mëparshme komuniste, nevoja është shtytëse. **KKGjE ka konsideruar se Karta Europiane – deri më tani, ashtu siç ka lobuar për intervenim (në kuptimin e gjerë të përfshirjes së një opinion, rekomandimi ose propozimi si dhe një vendimi aktual) të një autoriteti të pavarur me përfaqësim substancial të autoritetit të zgjedhur në mënyrë demokratike nga gjyqtarët tjerë<sup>12</sup> - ka theksuar drejtësinë e përgjithshme të cilin KKGjE ka dëshiruar ta lavdojë. Në veçanti kjo është e rëndësishme për shtetet të cilat nuk kanë sisteme tjera të krijuara prej kohërave të mëparshme dhe sisteme të dëshmuara në rrethana demokratike.**

#### *Koha e mbajtjes – periudha e emërimit*

46. Parimet bazë të KB, Rekomandimi nr. R (94) 12 dhe Karta Europiane për statutin e gjyqtarëve i referohen mundësisë së emërimit të një afati të caktuar ligjor në vend se të zgjedhet opsioni i moshës ligjore të pensionimit.

47. Karta Europiane, paragrafi 3.3 gjithashtu i referohet procedurave të rekrutimit që sigurojnë “periudhën e gjykimit, domosdoshmërisht të shkurtë pas nominimit në pozitën e gjyqtarit mirëpo para konfirmimit në baza permanente”.

<sup>11</sup> shih paragrafin 20 më lartë.

<sup>12</sup> shih paragrafet 38-39 më lartë.

48. Praktika Europiane në përgjithësi njih emërimet afat-gjata deri në kohën e caktuar ligjore për pensionim. Kjo është qasja më pak problematike në aspektin e pavarësisë.

49. Shumë sisteme të ligjit civil përfshijnë periudhat e trajnimit ose provës për gjyqtarë

50. Disa shtete bëjnë emërimet për një periudhë të caktuar të viteve ( për shembull në rastin e Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, për 12 vite). Gjyqtarët zakonisht emërohen në gjykata ndërkombëtare ( për shembull Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut) për periudha të kufizuara.

51. Disa shtete gjithashtu përdorin në mënyrë ekstensive zëvendës gjyqtarët , kohëzgjatja e të cilëve është e kufizuar ose më pak e mbrojtur se ajo e gjyqtarëve me orar të plotë ( për shembull në Britaninë e Madhe dhe në Danimarkë).

52. KKGjE ka konsideruar se kur , përjashtimisht, një emërim i plotë gjyqësor është për një periudhë të kufizuar, kjo periudhë nuk duhet të ripërtërihet përveç nëse procedurat ekzistojnë dhe sigurojnë se:

- i. Gjyqtari, nëse ai apo ajo dëshiron, merret parasysh për ri-emërim nga organi emërues dhe
- ii. Vendimi për ri-emërimin bëhet tërësisht në mënyrë objektive dhe me meritë dhe pa marrë parasysh konsideratat politike.

53. **The KKGjE ka konsideruar se kur kohëzgjatja është e kushtëzuar apo e kufizuar, organi përgjegjës për objektivitet dhe transparencë të metodës së emërimit ose ri-emërimit si gjyqtar me orar të plotë është tejet i rëndësishëm ( shih gjithashtu paragrafin 3.3 të Kartës Europiane).**

54. KKGjE ishte në dijeni se kushtet e referimit nuk bëjnë ndonjë referencë specifike në pozitën e gjyqtarëve në nivel ndërkombëtar. KKGjE ka lindur prej një rekomandimi ( nr23) në raportin e Personave të Mençur të 1998 sipas të cilit bashkëpunimi i drejtëpërdrejtë me institucionet nacionale të gjyqësorit duhet të implementohet dhe Rezoluta nr. 1 e adaptuar më vonë prej Ministrave të Drejtësisë në Konferencën e tyre të 22 –të në Chisinau gjatë 17-18 qershor 1999 që i referohej rolit të KKGjE si asistencë në bartjen e prioriteteve të identifikuar në planin global të veprimit “ për përforcim të rolit të gjyqtarëve në Europë dhe për këshillëdhënie ... nëse është e domosdoshme të azhurnohen instrumentet ligjore të Këshillit të Europës...”. Plani global i veprimit është i fokusuar fuqimisht në sistemet e brendshme ligjore të shteteve anëtare. Mirëpo nuk duhet të harrohet se kriteret për anëtarësimin e Këshillit të Europës përfshijnë “plotësimin e obligimeve prej Konventës Europiane për të drejta të njeriut” dhe se në këtë kontekst “ dorëzimi në Human Rights” and that in this respect “Dorëzimi në juridiksionin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të detyrueshme sipas të drejtës ndërkombëtare, është qartë standardi më i rëndësishëm i Këshillit të Evropës "(Raporti i personave të mençur, paragrafi 9).

KKGjE ka konsideruar se rëndësia në rritje e sipër për sisteme ligjore nacionale të gjykatave supranacionale dhe vendimet e tyre kanë bërë që inkurajimi i shteteve anëtare për respektim të parimeve të pavarësisë, palëvizshmërisë, emërimit he kohëzgjatjes së zyres në relacion me gjykatat e tilla supranacionale të jetë thelbësor ( shih paragrafin 52 më lartë).

55. **KKGjE është pajtuar se rëndësia e sistemeve ligjore nacionale gjyqtarëve në lidhje me obligimet që rezultojnë prej traktateve ndërkombëtare sikurse Konventa Europiane dhe traktatet e Bashkësisë Europiane jetësojnë faktin se emërimet dhe ri-emërimet e gjyqtarëve në gjykata duke interpretuar traktatet e tilla duhet të rezultojë me të njëjtën konfidencë dhe të respektojë të njëjtat parime sikurse sistemet ligjore nacionale. KKGjE më tej ka konsideruar se përfshirja nga autoriteti i pavarur i referuar në paragrafet 37 dhe 45 duhet të inkurajohet në lidhje me emërimin dhe ri-emërimin në gjykata ndërkombëtare.** Këshilli i Europës dhe institucionet e tij janë thjeshtë të themeluara në bazë të besimit në vlera superiore të përbashkëta me ato të një shteti anëtar dhe se besimi ka arritur efektin praktik të konsiderueshëm tanimë. Nëse aplikimi nuk do të ishte shtyer në nivel ndërkombëtar ato vlera dhe progresi që është arritur në zhvillimin dhe aplikimin e tyre do të nënvlerësoheshin.

*Mbajtja - Palëvizshmëria dhe disiplina*

57. Është parim themelor i pavarësisë gjyqësore që mbajtja të garantohet deri në moshën e obligueshme për pensionim ose përfundimi i mandatit të caktuar të zyrës: shih parimet bazë të KB, paragrafi 12; Rekomandimi nr. R (94) 12 Parimi I(2)(a)(ii) dhe (3) dhe Parimi VI (1) dhe (2). Karta Europiane vërteton se ky parim mbulon emërimin ose ri-emërimin në zyre të ndryshme ose edhe lokacion tjetër pa leje ( përveç në rastin e ri-organizimit të gjykatës ose në baza të përkohshme), mirëpo ai dhe Rekomandimi nr. R (94) 12 parashikonte se transferi i këtyre detyrave mund të urdhërohet përmes sanksioneve disiplinore.

58. KKGjE ka theksuar se Republika Çeke nuk ka ndonjë moshë pensionimi të caktuar mirëpo gjyqtari mund të ri-thirret nga Ministri i Drejtësisë prej pozitës së tij pasi të arrijë moshën 65 vjeçe”.

59. Ekzistenca e përjashtimeve për palëvizshmëri sidomos atyre që rezultojnë prej sanksioneve disiplinore, dërgon menjëherë tek marrja në konsideratë e organit dhe metodës përmes së cilës dhe bazuar në të cilën, gjyqtarët mund të disiplinohen. Rekomandimi nr. R (94) 12, Parimi VI(2) dhe (3), insiston në nevojën për përcaktim preciz të veprave penale për të cilat gjyqtari mund të largohet prej zyrës dhe për procedurat disiplinore që përputhen me kërkesat e procesit të Konventës për të drejtat e njeriut. Më tej, thotë vetëm se “ Shtetet duhet të marrin parasysh themelimin, me ligj , të organit kompetent të veçantë i cili ka si detyrë aplikimin e çfarëdo sanksioneve dhe masave disiplinore, kur ato nuk trajtohen përmes gjykatës, dhe vendimet e të cilit do të kontrollohen nga organi gjyqësor superior apo të jetë vet ky organi superior gjyqësor. Karta Europiane i përcakton këtë rol autoritetit të pavarur që sugjeron se duhet të “ intervenojë” në të gjitha aspektet e selektimit dhe promovimit të çdo gjyqtari.

**60. KKGJE ka konsideruar**

**(a) se palëvizshmëria e gjyqtarëve duhet të jetë një element që shprehë pavarësinë e ruajtur në nivelin më të lartë të mundshëm ( shih paragrafin 16 më lartë);**

**(b) Se intervenimi i një autoriteti të pavarur<sup>13</sup> me procedura që garantojnë të drejtat e plota të mbrojtjes ka rëndësi shumë të madhe për sa i përket disiplinës; dhe**

**(c) se do të ishte e dobishme të përgatiten standardet që përcaktojnë jo vetëm sjelljen që mund të dërgojë deri tek largimi prej zyres mirëpo të gjitha sjelljet që mund të dërgojnë deri tek hapat disiplinor ose ndryshimi i statusit duke përfshirë për shembull lëvizjen në gjykatë apo fushë tjetër.**

Opinionimi i detajuar i KKGjE në një fazë më të vonshme kur merret shprehimisht me standardet e sjelljes edhe pse nuk ka ndonjë dyshim se ata kanë ndonjë relacion të brendshëm të fuqishëm me temën aktuale të pavarësisë.

#### *Pagesa*

61. Rekomandimi nr. R (94) 12 siguron që “pagesa e gjyqtarëve të garantohet me ligj” dhe “kompenzimi të bëhet me dinjitetin e profesionit të tyre dhe barrën e përgjegjësive” (parimet I(2)(a)(ii) dhe III(1)(b)). Karta Europiane përmban një njohje të rëndësishme, të fuqishme dhe reale të rolit të pagesës adkuate si mbrojtje “prej presioneve që kanë si synim ndikimin në vendimet e tyre dhe më në përgjithësi sjelljen e tyre...” dhe për rëndësinë e pushimit të garantuar mjekësor dhe pensionet adekuate (paragrafi 6). **KKGjE ka aprovuar plotësisht deklaratën e Kartës Europiane.**

62. Përderisa disa sisteme (për shembull në shtetet Nordike) sigurojnë situatën përmes mekanizmave tradicional pa ndonjë dispozitë formale ligjore, KKGjE ka konsideruar se ishte përgjithësisht e rëndësishme (e sidomos në lidhje me demokracitë e reja) të krijohet një dispozitë specifike ligjore që garanton pagat e gjyqësorit përkudër reduktimit dhe për të siguruar së paku dispozitën për rritje të pagave në përputhje me koston e jetesës.

#### *Liria prej influencës së jashtme të paligjshme*

63. Liria prej influencave të jashtme të paligjshmea krijon një parim të përgjithshëm të mirënjohur: shih parimet bazë të BE-së, paragrafi 2; Rekomandimi nr. R (94) 12, Parimi I(2)(d), që vazhdon: “Ligji duhet të sigurojë sanksione kundër personave që kërkojnë të ndikojnë në gjyqtarë në çfarëdo mënyre”. Si parim i përgjithshëm, liria prej influencës së paligjshme dhe nevoja në raste ekstreme për sanksione janë të pamohueshme<sup>14</sup>. Për më tepër, KKGjE nuk ka ndonjë arsye të mendojë se ato nuk janë ofruar në mënyrë të përshtatshme në ligjin e shteteve anëtare. Në anën tjetër, operimi i tyre në praktikë kërkon kujdes, kontroll dhe në disa kontekste edhe kufizim politik. Diskutimet me dhe të kuptuarit dhe mbështetja e gjyqtarëve prej shteteve të ndryshme do të tregojë si e vlefshme në këtë lidhje. Vështirësia qëndron në të vendosurit se cka krijon influencë dhe në prerjen e një balance të përshtatshëm ndërmjet për shembull nevoja për të mbrojtur procesin gjyqësor kundër shtrembërimit dhe presionit, prej burimeve politike, shtypit apo burimeve tjera dhe intereseve për diskutime të hapura të çështjeve të interes publik në jetën publike dhe në shtypin e lirë.

<sup>13</sup> Shih paragrafet 37 dhe 45 më lart

<sup>14</sup> Shih gjithashtu balancin ndërmjet parimit të përgjithshëm të lirisë së shprehjes dhe përjashtimit (ku kërkohen hapa për mirëmbajtje të autoritetit dhe paanësi të gjyqësorit) në nenin 10 të ECHR.

Gjyqtarët duhet të pranojnë se ata janë figura publike dhe nuk duhet të dyshohen ose të jenë shumë të brishtë. **KKGjE është pajtuar se nuk duket që ka nevojë për ndryshim të parimeve ekzistuese mirëpo gjyqtarët në shtetet e ndryshme do të mund të përfitonin prej diskutimeve të përbashkëta dhe prej shkëmbimit të informatave rreth situatës së caktuar.**

*Pavarësia brenda gjyqësorit*

64. Pika thelbësore është se gjyqtari është në performancën e funksioneve të tij punonjësi i askujt; Ai apo ajo është udhëheqës i zyrës së shtetit. Ai apo ajo është shërbyes pra dhe i përgjigjet vetëm ligjit. Është e pakundërshtueshme se kur gjyqtari vendos për një rast nuk vepron në ndonjë urdhër apo udhëzim të palës së tretë brenda apo jashtë gjyqësorit.

65. Rekomandimi nr. R (94) 12, Parimi I(2)(a)(i) siguron se “vendimet nuk do të jenë subjekt i ndonjë ndryshimi jashtë procedurave të apelit ashtu siç kërkon ligji” dhe Parimi I(2)(a)(iv) siguron se “me përjashtim të vendimeve për amnesti, falje apo ngjashëm, qeveria ose administrata nuk duhet të jenë në gjendje të marrin çfarëdo vendimi që i shpallë të pavlera vendimet juridike në mënyrë retroaktive. **KKGjE ka theksuar se reagimet në pyetësor kanë treguar që këto parime janë vrojtuar në përgjithësi dhe asnjë amendament nuk është sugjeruar.**

66. KKGjE ka theksuar rrezikun potencial për pavarësinë e gjyqësorit që do të mund të shfaqej prej një hierarkie të brendshme në gjyqësor. E ka pranuar se pavarësia e gjyqësorit varet jo vetëm prej lirisë prej influencave të jashtme të paligjshme mirëpo edhe prej lirisë prej influencës së jashtme të paligjshme që do të mund të shfaqej në disa situata prej qëndrimit të gjyqtarëve tjerë. “Gjyqtarët duhet të kenë lirinë e plotë të vendosin për raste në mënyrë të paanshme, në pajtim me vetëdijen dhe interepretimin e tyre të fakteve dhe në përputhje me rregullat mbizotëruese të ligjit” (Rekomandimi nr. R (94) 12, Parimi I (2)(d). Kjo do të thotë gjyqtarët individualisht. Kushtet në të cilat ajo është e shtrirë nuk përjashtojnë doktrina të tilla si ajo e precedentit në vendet e ligjit zakonor (dmth. obligimin e gjyqtarit më të ulët për të ndjekur një vendim të mëparshëm për një gjykatë më të lartë në një pikë të ligjit që del direkt në rastin më vonë).

67. Parimi I (2) (d) vazhdon: "Gjyqtarët nuk duhet të jenë të detyruar që të raportojnë për meritat e rasteve të tyre për të gjithë jashtë gjyqësorit". Kjo është, në çdo pikëpamje, e panjohur. "Raportimi" për meritat e rasteve, madje edhe të anëtarëve të tjerë të gjyqësorit, duket në vështrimin e parë në kundërshtim me pavarësinë individuale. Nëse vendimi do të jetë aq i paaftë që të arrijë në një shkelje disiplinore që mund të jenë të ndryshme, por, në këtë rast shumë të largët, gjyqtari nuk do të "raportonte" në të gjitha, por do të përgjigjet në mënyrë korrekte.

68. Fuqia hierarkike e dhënë në shumë sisteme ligjore mbi gjykatat superiore mundet në praktikë të shkatërrojë pavarësinë gjyqësore individuale. Një zgjidhje do të ishte për të transferuar të gjitha kompetencat përkatëse të Këshillit Gjyqësor të Lartë, i cili më pas do të mbrojë pavarësinë brenda dhe jashtë gjyqësorit. Kjo dërgon përsëri në rekomandimin e Kartës Evropiane për statutin e gjyqtarëve, për të cilin vëmendja tashmë është fokusuar nën titullin e *trupave emëruese dhe konsultative*.

69. Sistemet inspektuese të gjykatës, në ato shtete ku ekzistojnë, nuk duhet të brengosen me meritat ose korrektësinë e vendimeve dhe nuk duhet t'i dërgojnë gjyqtarët sipas efikasitetit në favorizim të produktivitetit në krahasim me performancën e përshtatshme të rolit të tyre, që do të sjellë deri tek një vendim i marrë parasysh duke mirëmbajtur dhe marrë parasysh interesin e atyre që kërkojnë drejtësi<sup>15</sup>.

70. KKGjE ka theksuar lidhjen e sistemit modern Italian të ndarjes së gradës, pagës dhe zyres të përshkruar në paragrafin 30 më lart. Qëllimi i këtij sistemi është të zbatohet pavarësinë dhe gjithashtu do të thotë se rastet e vështira të instancës së parë ( për shembull në Itali, rastet e mafias) mund të gjykohen nga gjyqtarë që kanë kualifikime shumë të larta.

### *Roli i Gjyqësorit*

71. Ky titull do të mund të mbulonte një fushë të gjerë. Pjesa më e madhe e kësaj fushe do të paraqitet për marrje në konsideratë kur KKGjE shqyrton temat e standardeve dhe më mirë është të lihet deri atëherë. Kjo vlen për tema individuale sikurse anëtarësimi në parti politike dhe angazhimi në aktivitete politike.

72. Një temë e rëndësishme e prekur gjatë takimit të KKGjE ka të bëjë me ndërrime të brendshme në disa sisteme të posteve të gjyqtarëve, prokurorëve publik dhe zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë. Përkundër këtij ndërrimi të brendshëm, KKGjE ka vendosur se konsiderimi i rolit, statusit dhe detyrave të prokurorëve public në paralele me ato të gjyqtarit shtrohet në termet e referencës. Megjithatë prapë na mbetet një pyetje e rëndësishme nëse sistemi është konsistent me pavarësinë e gjyqësorit. Kjo është temë që nuk ka ndonjë dyshim se është shumë e rëndësishme për sistemet e prekura ligjore. **KKGjE ka konsideruar se do të mund të meritonte konsideratë të mëtejme në një fazë më të vonshme ndoshta në lidhje me studimin e rregullave të sjelljes së gjyqtarëve, mirëpo për këtë do të nevojitej input i mëtejme i specialistit.**

### Konkludime

73. KKGjE ka konsideruar se çështje kritike për shtetet anëtare është të vë në efekt të plotë parimet që tanimë janë zhvilluar ( paragrafi 6 ) dhe pas ekzaminimit të standardeve të përfshira në veçanti Rekomandimin nr. R (94) 12 për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve, kështu që ka konkluduar si vijon:

(1) Parimet thelbësore të pavarësisë së gjyqësorit duhet të vendosen në nivelin kushtetues apo më lartë në secilin shtet anëtar dhe rregulla më specifike në nivelin legjislativ ( paragrafi 16).

(2) Autoritetet përgjegjëse në secilin shtet anëtar për emërime dhe promovime duhet të paraqesin, publikojnë dhe ti japin efekt kritereve objektive me qëllim të sigurimit se selektimi dhe kariera e gjyqtarit janë bazuar në meritë duke pasur parasysh kualifikimin, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin ( paragrafi 25).

(3) Senioriteti nuk duhet të jetë parim qeverisës kur përcaktohet promovimi. Përvoja adekuate profesionale është megjithatë relevante dhe parakushtet në lidhje me vitet e përvojës mund të ndihmojnë në mbështetje të pavarësisë (paragrafi 29) .

<sup>15</sup> Shih gjithashtu paragrafin 27 më lartë



- (4) KKGjE ka konsideruar se Karta Europiane për statutin e gjyqtarëve – deri më tani siç ka lobuar për intervenimin e një autoriteti të pavarur me përfaqësim të denjë gjyqësor i zgjedhur në mënyrë demokratike nga gjyqtarët tjerë- ka treguar nga një drejtim i përgjithshëm të cilin e ka lavduar KKGjE ( paragrafi 45).
- (5) KKGjE ka konsideruar se kur koha e mbajtjes së pozitës është e kushtëzuar apo e limituar, organi përgjegjës për objektivitet dhe transparencë të metodës së emërimit ose ri-emërimit si gjyqtar me orar të plotë janë tejet me rëndësi ( shih gjithashtu paragrafin 3.3 të Kartës Europiane) ( paragrafi 53)..
- (6) KKGjE është pajtuar se rëndësia e sistemeve ligjore nacionale dhe gjyqtarët në lidhje me obligimet që rezultojnë prej traktateve ndërkombëtare sikurse Konventa Europiane dhe traktatet e Bashkësisë Europiane e jetësojnë faktin se emërimi dhe ri-emërimi i gjyqtarëve në gjykata ku interpretohen traktate të tilla duhet të ketë besim dhe respekt për të njëjtat parime sikurse sistemet ligjore nacionale. KKGjE më tej ka konsideruar se involvimi prej autoritetit të pavarur referuar në paragrafet 37 dhe 45 duhet të inkurajohet në lidhje me emërimin dhe ri-emërimin në gjykata ndërkombëtare ( paragrafi 56)
- (7) KKGjE ka konsideruar se palëvizshmëria e gjyqtarëve duhet të jetë një element që shprehë pavarësinë e ruajtur në nivelin më të lartë të brendshëm (paragrafi 60)
- (8) Pagesa e gjyqtarëve duhet të bëhet në përputhje me rolin e tyre dhe përgjegjësite dhe duhet të sigurohet edhe pagesa për pushim mjekësor dhe pension. Do të duhej të garantohej prej dispozitës specifike ligjore kundër reduktimit dhe duhet të ketë dispozitë për rritjet në linjë me koston e jetesës ( paragrafet 61-62).
- (9) Pavarësia e cilitdo gjyqtar të pavarur në performancën e funksioneve të tij ose saj ekziston pa marrë parasysh hierarkinë e brendshme në gjykatë ( paragrafi 64).
- (10) Përdorimi i të dhënave statistikore dhe sisteme të inspektimit në gjykata nuk do të shërbejë si paragjykim për pavarësi të gjyqtarëve ( paragrafi 27 dhe 69).
- (11) KKGjE ka konsideruar se do të ishte e dobishme që të përgatiten rekomandime shtesë apo të amendamentohet Rekomandimi nr. R (94) 12 në aspekt të këtij opinion dhe puna e mëtejme të bëhet prej KKGjE.